



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Keshilli Drejtues-**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, me \_\_. 03. 2010

**V E N D I M**  
**Nr.1182, date 10. 03. 2010**

**Per**

**“Miratimin e Tarifave te propozuara nga sipermarresi Albtelecom sh.a”**

Keshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i perbere nga:

- |                |            |         |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro     | Xhixho     | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar  |
| 3. Z. Benon    | Paloka     | Anëtar  |
| 4. Z. Ibsen    | Elezi      | Anëtar  |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe      | Anëtar  |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 10.03. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, me objekt:

**“Miratimin e Tarifave te propozuara nga sipermarresi Albtelecom”**,

mori ne shqyrtim materialet shkretores te perbera nga:

- Tarifat e propozuara nga sipermarresi “Albtelecom” Sh.a.;
- Relacioni i Drejtorise Rregullimit Ekonomik te AKEP;
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas percaktimeve te parashikuara ne nenin 106 e ne vijim te ligjit nr. 8485.

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 53 e vijues te ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Rregullore e Brendshme e AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-se, Nr. 170, date 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe ne fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

3. Vendim i KD të AKEP-it, Nr. 472, datë 09. 07. 2008 “Per caktimin e dates se fillimit te rregullimit te tarifave te organizmit me fuqi të ndjeshme ne treg “Albtelecom S.h.A”.

Nga administrimi i materialeve shkresore, fakteve te paraqitura, bazes ligjore te sipercituar, si dhe diskutimeve gjate mbledhjes:

#### **V E R E H E T se:**

1. Albtelecom me shkresen Nr.Prot.709, date 08.02.2010, ka depozituar ne AKEP kerkesen per miratimin e tarifave duke iu referuar pikes 16, Lidhja 2 te VKM Nr. 854, konkretisht tarifave per periudhen e IV-te nen-rregullim.

2. Ne baze te pikes 11 te metodologjise se rregullimit te tarifave te Albtelecom, vlera e e faktorit It qe perdoret ne formule per peirudhen e katert Mars-Shator 2010, do te jete vlera e ndryshimit vjetor te ICK te publikuar nga Instat per vitin 2009, e cila eshte 3.5% (nga 2.2 dhe 3.1% ne vitet 2007 dhe 2008).

3. Lidhur me “ Nenshporta nr.1: Pajtimi mujor per kategorine familjare”:

Tarifa e propozuar eshte 442 leke/muaj, c’ka perben ndryshim prej 23.46% nga tarifa aktuale 358 leke/muaj (periudha e III-te nen-rregullim). Vlera maksimale e lejuar sipas pikes 10/b te metodologjise se rregullimit te tarifave eshte  $3.5\% - (-20\%) = 23.50\%$ . Rritja e tarifes prej 23.46% eshte me e vogel se 23.50% e cila eshte e lejuar nga Metodologjia e Rregullimit te Tarifave te Albtelecom per fazen IV nen-rregullim.

4. Lidhur me “Nenshporta nr.2: Bisedime telefonike lokale”:

Vlerat e tarifave te propozuara nga Albtelecom çojne ne ndryshim mesatar te tarifave te thirrjeve lokale me -1.51 %, e cila eshte me e ulet se ndryshimi i lejuar nga pika 10/d  $3.5\% - (-10.5\%) = 14\%$ . Gjithashtu ndryshimi i tarifes se thirrjeve lokale per kategorine familjare, brezi kohor i zakonshem eshte 3.2%, qe eshte me e vogel se rritja maksimale e lejuar prej 12%, sipas paragrafit te dyte te pikes 10 te Metodologjise Rregullimit te Tarifave te Albtelecom.

5. Lidhur me “Nenshporta nr.3: *Thirrje telefonike kombetare (midis rajoneve) per kategorine familjare*”:

Tarifa e propozuar nga Albtelecom eshte 6.38 lek/minute (peak) dhe 5.13 lek/minute (off peak) ne krahasim me tarifat aktuale 7.5 lek/minute(peak) dhe 6.32 lek/minute (off peak). Reduktimi mestar eshte 15.14%, i cili eshte me i madh se reduktimi i imponuar prej 11.5% (3.5%-15%) sipas paragrafit te dyte te pikes 10 te Metodologjise Rregullimit te Tarifave te Albtelecom.

6. Lidhur me “ Nenshporta nr.4: Per sherbimet biseda nderkombetare (familjare dhe te tjere)”:

Per kete nen-shporte jane bere disa korigjime nga AKEP (pika 15 e metodologjise):

- Vlerat e kolones 6 (pjesa e mbajtur ne fund te periudhes) te dhena nga Albtelecom jane zevendesuar me vlerat e pjeses se mbajtur te propozuar nga Albtelecom dhe miratuar nga AKEP per periudhen e III-te.
- Vlerat e detyrimeve per operaoret e huaj jane rillogaritur duke perdorur kursin mesatar te kembimit per vitin 2009 1 Euro =132.06 Lek, ne vend te kursit te kembimit 1 Euro=137.17 lek te perdorur nga Albtelecom (pika 22 e Metodologjise)
- Tarifate e propozuara nga Albtelecom per pajtimtaret Familjare, per thirrjet nderkombetare ne brezin kohor te reduktuar (off peak) jane zevendesuar me tarifate e miratuara nga AKEP per periudhen e III-te nen-rregullim, pasi tarifate e propozuar ishin me rritje (megjithese e vogel)dhe ne kundershtrim me piken 20 te Metodologjise.

Sipas tarifave te propozuara nga Albtelecom dhe ne baze te korigjimeve te mesiperme, per 10 shtetet e perfshira ne shporte, reduktimi mesatar i pjeses se mbajtur per biseda nderkombetare eshte 22.85% i cili eshte me i madhe se reduktimi i imponuar prej 11.5% (3.5%- 15%), sipas paragrafit te dyte te pikes 10 te Metodologjise Rregullimit te Tarifave te Albtelecom.

#### 7. Lidhur me “ Shporta e pergjithshme”:

Ne shporten e pergjithshme jane reflektuar ndryshimet e mesiperme, te kryera per nen-shporten nr.4 si edhe:

- Vlerat e kolones 6 (pjesa e mbajtur ne fund te periudhes) per thirrjet drejt operatoreve celulare dhe operatoreve te tjere fiks, te dhena nga Albtelecom jane zevendesuar me vlerat e pjeses se mbajtur te propozuar nga Albtelecom dhe miratuar nga AKEP per periudhen e III-te.
- Tarifate e propozuara nga Albtelecom per pajtimtaret Familjare dhe Te tjere, per thirrjet kombetare drejt rrjeteve te tjere fiks, jane zevendesuar me tarifate e miratuara nga AKEP per periudhen e III-te nen-rregullim per pajtimtaret Familjare, pasi tarifate e propozuar ishin me rritje dhe ne kundershtrim me piken 20 te Metodologjise.

Nga shqyrtimi i vlerave dhe treguesve te shportes se pergjithshme sipas propozimit te Albtelecom dhe korigjimeve te mesiperme, rezulton se ndryshimi mesatar per shporten e pergjithshme eshte -0.45%, vlere e cila eshte me vogel se 0% (3.5%-3.5%) sipas pikes 10/a te Metodologjise Rregullimit te Tarifave te Albtelecom.

Respektimi i pikave te tjera te metodologjise:

- Ne perputhje me piken 19 te Metodologjise, tarifate e propozuar nga Albtelecom per thirrjet telefonike te pajtimtareve Familjare dhe Te Tjere, jane te barabarta, duke eliminuar diferencen qe ekzistonte ne keto tarifa (tarifate e thirrjeve te pajtimtareve Te Tjere kane qene 50% me te larta para aplikimit te metodologjise dhe jane reduktuar deri ne 30 ne fazen e III-te).

**8.** Propozimi i paraqitur nga Albtelecom Sh.A per nivelin e tarifave, pas korigjimeve te AKEP, eshte sipas kerkesave te metodologjise te rregullimit te tarifave te operatorit Albtelecom Sh.A. te miratuar me VKM Nr.854.

## 9. Lidhur me “Tarifimi per sekonde dhe impulse”:

Albtelecom me shkresen Nr.709 Prot., date 8.02.2010, me te cilen ka depozituar ne AKEP propozimin per tarifat e reja per periudhen e IV nen-rregullim, ka cituar se do te aplikojte tarifimin per sekonde (per peridhen IV), ne perputhje me piken 18 te metodologjise. Albtelecom gjithashtu ka kerkuar qe AKEP te marre ne konsiderate, aplikimin e nje tarife ‘start up fee’ per thirrjet telefonike, duke dhene edhe shembuj te aplikimit te saj nga operatore te rrjeteve fikse incumbent ne vendet e rajonit. Vlera e propozuar nga Albtelecom eshte 60 sekonda per thirrje lokale, dhe 30 sekonda per thirrjet kombetare.

Pika 18 e metodologjise, percakton si detyrim per Albtelecom, tarifimin per sekonde te thirrjeve lokale si edhe thirrjeve te tjera, duke filluar nga faza e dyte e implementimit te metodologjise, d.m.th nga data 15 Mars 2009. Albtelecom ka vene ne dijeni AKEP, ne muajin shkurt 2009 se nuk mund te kalonte ne sistemin tarifar ne baze sekonde ne periudhen e dyte nen rregullim si pasoje e mos implementimit te sistemit te billingut ne baze sekonde dhe se Albtelecom ishte ne negociata me kompanine e cila do implementojte kete sherbim. Nepermjet takimeve dhe njoftimeve te tjera rezulton se Albtelecom, nuk e ka aplikuar ende kete detyrim, dhe me shkresen nr.212/3, date 15.02.2010, njofton AKEP se do te filloje tarifimin per sekonde per te gjitha abonentet per faturen e mujit Prill 2010.

Aktualisht kjo eshte nje praktike normale ne vende te tjera, dhe aplikohet edhe nga operoret celulare ne Shqiperi. Nderkohe meqenese kjo faze do te zgjase vetem 6 muaj, dhe AKEP bazuar ne rezultatet e modelit BULRAIC, do te hartojte nje metodologji te re, AKEP gjykon qe kjo kerkese e Albtelecom te mos aplikohet tani, por te merret ne konsiderate per rregullimin e tarifave pas perfundimit te metodologjise aktuale.

AKEP duke marre ne konsiderate:

- Pika 18 e metodologjise eshte vendosur me qellimin qe pajtimtaret e Albtelecom te paguajne per cdo thirrje ekzaktesisht sa eshte kohezgjatja e thirrjes dhe aplikimi i tarifimit me impulse qe ka kohezgjatje me shume se 1 sekonde con ne tarife efektive me te larte se tarifa e shprehur.
- Pajtimtaret e Albtelecom nuk paguajne ‘start up fee’ apo kohe minimale tarifimi, praktike e cila eshte normale ne shume vende te tjera, perfshire operoret celulare ne Shqiperi.
- Procesi i ribalancimit te tarifave te Albtelecom, pervecse eshte i nevojshem, ka pasur disa efekte negative tek perdoruesit e vegjel, qe konsumojne kryesisht thirrje lokale;

AKEP, me qellim rritjen e perfitimeve per konsumatorët dhe njekohesisht implementimin metodologjise, gjykon qe:

- Rritja e tarifes se pajtimit mujor nga 358 lek/muaj ne 442 lek/muaj te kryhet me date 1 Qershor 2010, dhe vetem nese Albtelecom fillon aplikimin e tarifimit per sekonde ne faturimin e muajit Prill. Çdo vonese ne impelemntimin e tarifimit per sekonde nga Albtelecom do te coje ne mos-aplikimin rritjes se tarifes se pajtimit mujor per pajtimtaret Familjare.
- Kerkesa e Albtelecom per aplikimin e start up fee apo kohe minimale tarifimi te mos pranohet per kete faze te fundit te metodologjise, por te merret ne konsiderate

per rregullimin e mevonshem te tarifave te Albtelecom pas perfundimit te implementimit te metodologjise aktuale.

**10.** Sipas nenit 57 te ligjit nr. 9918, AKEP-i per rregullimin e tarifave zbaton nje nga metodat e percaktuara ne kete dispozite. Metodologjia e miratuar me VKM 854 perben nje metodologji te parashikuar ne keto percaktime.

### **P Ë R K E T O A R S Y E:**

Keshilli Drejtues, duke konsideruar rendesine e miratimit te tarifave per sipermarresin Albtelecom Sh.a, pajtimtaret e Albtelecom dhe konkurrencen ne tregun e sherbimeve te telefonise fikse, bazuar nenin 53 e vijues, piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme,

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e nivelit te tarifave të reja për përdoruesit fundorë per Kategorite e pajtimtareve “Familjare” dhe “Te Tjere”, sipas ndryshimeve te kryera nga AKEP dhe te paraqitura ne Aneks 1 bashkangjitur.
2. Aplikimi i nivelit te tarifave te reja te Albtelecom te filloje me daten 1.04.2010, me perjashtim te tarifes se re te pajtimit mujor per pajtimtaret Familjare.
3. Tarifa e re e pajtimit mujor per pajtimtaret Familjare te filloje te aplikohet me 1.07.2010, me kusht qe Albtelecom te aplikojte tarifimin per sekonde duke filluar nga faturat e muajit Prill 2010.
4. Mos-pranimin e kerkeses se Albtelecom per perfshirje te ‘start-up fee’ apo kohe minimale tarifimi ne tarifat e fazes IV nen rregullim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **A N E T A R E T:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**

## Aneks 1

Tarifat e miratuara nga AKEP per tu aplikuar nga Albtelecom sh.a. per pajtimtaret e kategorive Familjare dhe Te tjere: Faza e IV-te nen rregullim: 1.04.2010-1.10.2010

Nr.	Sherbimi	Njesia Matese	Tarifa e Perdoruesit e Miratuar per tu aplikuar me 01.04.2010	
			Familjare	Te Tjere
1	Pajtimi Mujor	Lek/muaj	1 Prill-30 Qershor 2010: 358	1.500
			1 Korrik 2010: 442	
2	Instalim Telefonik	Lek	4.000	4.000
<b>Biseda Telefonike LOKALE</b>				
3	3,1 Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00- 22:00	Lek /minute	2,58	2,58
	3,2 Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek /minute	1,61	1,61
<b>Biseda Telefonike KOMBETARE brenda rrjetit Albtelecom</b>				
4	4,1 Brenda Rajonit			
	4.1.1 Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00- 22:00	Lek/minute	3,00	3,00
	4.1.2 Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	2,50	2,50
	Midis Rajoneve			
	4.2.1 Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00- 22:00	Lek/minute	6,38	6,38
	4.2.2 Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	5,13	5,13
<b>Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve te tjere fiks</b>				
5	5,1 Lokale			
	5.1.1 Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00- 22:00	Lek/minute	3,00	3,00
	5.1.2 Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	2,00	2,00

	5,2	Brenda Rajonit			
	5.2.1	Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00-22:00	Lek/minute	<b>4,48</b>	<b>4,48</b>
	5.2.2	Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	<b>3,90</b>	<b>3,90</b>
	5,3	Midis Rajoneve	"		
	5.3.1	Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00-22:00	Lek/minute	<b>8,45</b>	<b>8,45</b>
	5.3.2	Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	<b>6,74</b>	<b>6,74</b>
6	<b>Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve celulare</b>				
	6,1	Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00-22:00	Lek/minute	<b>26,09</b>	<b>26,09</b>
	6,2	Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	<b>20,00</b>	<b>20,00</b>
7	<b>Biseda Telefonike NDERKOMBETARE</b>				
	7,1	ZONA I			
	7.1.1	Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00-22:00	Lek/minute	<b>15,38</b>	<b>15,38</b>
	7.1.2	Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	<b>11,78</b>	<b>11,78</b>
	7,2	ZONA II			
	7.2.1	Brezi Orar i ZAKONSHEM 08:00-22:00	Lek/minute	<b>37,58</b>	<b>37,58</b>
	7.2.2	Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 - 08:00	Lek/minute	<b>28,57</b>	<b>28,57</b>

*Shenim:*

*Tarifat jane pa TVSH*

*Tarifimi i thirrjeve behet ne baze te kohezgjatjes se thirrjes e matur ne sekonda (per second charging).*

### **Tarifat e Thirrjeve nderkombetare drejt 10 shteteve te shportes nen-rregullim (lek/minute pa TVSH)**

7.1.0	<b>Biseda telefonike NDERKOMBËTARE, brezi orar PIK, drejt:</b>			
			<b>Familjare</b>	<b>Te Tjere</b>
7.1.1	ITALI	Fiks	15,38	15,38
7.1.2		Celular	37,58	37,58
7.2.1	GREQI	Fiks	15,38	15,38
7.2.2		Celular		37,58

			37,58	
7.3.1	MAQEDONI	Fiks	15,38	15,38
7.3.2		Celular	37,58	37,58
7.4.1	KOSOVË	Fiks	15,38	15,38
7.4.2		Celular	37,58	37,58
7.5.1	MALI I ZI	Fiks	15,38	15,38
7.5.2		Celular	37,58	37,58
7.6.1	GJERMANI	Fiks	15,38	15,38
7.6.2		Celular	37,58	37,58
7.7.1	FRANCË	Fiks	15,38	15,38
7.7.2		Celular	37,58	37,58
7.8.1	ANGLI	Fiks	15,38	15,38
7.8.2		Celular	37,58	37,58
7.9.1	SHBA	Fiks	15,38	15,38
7.9.2		Celular		
7.10.1	KANADA	Fiks	15,38	15,38
7.10.2		Celular		
8.1.0	<b>Biseda telefonike NDERKOMBËTARE, brezi orar i Reduktuar, drejt:</b>			
8.1.1	ITALI	Fiks	11,78	11,78
8.1.2		Celular	28,57	28,57
8.2.1	GREQI	Fiks	11,78	11,78
8.2.2		Celular	28,57	28,57
8.3.1	MAQEDONI	Fiks	11,78	11,78
8.3.2		Celular	28,57	28,57
8.4.1	KOSOVË	Fiks	11,78	11,78
8.4.2		Celular	28,57	28,57
8.5.1	MALI I ZI	Fiks	11,78	11,78
8.5.2		Celular	28,57	28,57
8.6.1	GJERMANI	Fiks	11,78	11,78
8.6.2		Celular	28,57	28,57
8.7.1	FRANCË	Fiks	11,78	11,78



8.7.2		Celular	28,57	28,57
8.8.1	ANGLI	Fiks	11,78	11,78
8.8.2		Celular	28,57	28,57
8.9.1	SHBA	Fiks	11,78	11,78
8.9.2		Celular		
8.10.1	KANADA	Fiks	11,78	11,78
8.10.2		Celular		

*Tarifimi i thirrjeve behet ne baze te kohezgjatjes se thirrjes e matur ne sekonda (per second charging).*